

UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E POS TERMINALIT MOVE3500



Në këtë manual janë të përshkruara veprimet si:

- 1. FUNKSIONET E POS TERMINALIT**
- 2. SHITJE**
- 3. ANULIM**
- 4. RIPRINTIM FATURE**
- 5. MBYLLJE DITE**
- 6. RISTARTIMI I POS TERMINALIT**
- 7. ZËVENDËSIMI I LETRËS NË TERMINAL.**

Në vazhdim është paraqitur përshkrimi i funksioneve dhe paraqitja e tyre me figura:

Funksionet e POS Terminalit:



LEXIMI I KARTELAVE

Kartelat me shirit magnetik

Kartela mund të lexohet ose nga poshtë lart ose nga lart poshtë, me shiritin përballë terminalit.

Përdorni një lëvizje të rregullt për të siguruar një lexim të besueshëm të kartës.



Kartela me çip

Fusni kartelën horizontalisht në terminal, me çipin të kthyer nga ana e tij lart.


Lëreni kartelën në këtë pozicion, gjatë gjithë transaksionit.



Kartela contactless – pakontakt

Afrojeni kartelën deri në zonën aktive mbi logon pa kontakt të vendosur në kapakun e printerit të letrës.

Mbajeni kartën pranë logos pakontakt gjatë transaksionit dhe katër (4) LED indikatorë do të ndizen në mënyrë sekuenciale gjatë transaksionit.



FUNKCIONI SHITJE:

Në ekranin e POS Terminalit, në gjendje të rregullt, gjatë tërë kohës paraqitet kjo skemë:



Hapi i parë për realizimin e SHITJES është shtypja e butonit F1 dhe vendosja e shumës që realizohet :




pas vendosjes së shumës (p.sh 12.30 Euro) vazhdohet me ENTER dhe në ekran shfaqet figura si mëposhtë:



pastaj vazhdohet me kalimin e kartelës në POS Terminal si në figure:



ose pagesat që realizohen me contactless, ku nuk kërkohet PIN i kartelës (për momentin maksimumi i vlerës për pagesë është deri 50 EUR).



Pas vendosjes së kartelës apo kalimit të saj në POS Terminal, si në fig. e mësipërme, në ekran do të paraqitet skema e mëposhtme:




Pas shtypjes së PIN-it, në ekran paraqiten të dhënat si në vijim. Këto të dhëna vlejné për të gjitha rastet kur ekzekutimi bëhet në Terminal, këto të dhëna paraqesin lidhjen (komunikimin) e Terminalit me Qendrën Procesuese:

- **GPRS duke u lidhur...**
- **Duke marrur/ duke përpunuar...**
- **Aprovuar xxxx...**

ANULIMI I TRANSAKCIONIT


Në rastin e anulimit të transakcionit, zgjidh opcionin ANULO (si në ekran), me ndihmën e tastit F2 (shih figurën e mëposhtme).




Pasi të kemi zgjidhur opcionin ANULO, në ekran na shfaqën kërkesa për logim të tregtarit, ku duhet të vendoset password-I për të vazhduar më tutje me procesin e anulimit:



Pasi të është vendosur password-i (që e posedon pronari apo menaxheri I biznesit), në ekran do të paraqitet skema e mëposhtme:



Nëse deshirojmë të anulohet transaksionin e fundit, atëherë zgjidhim opcionin - E FUNDIT, mirëpo nëse dëshirojmë të anulohet ndonjë transaksion të mëhershëm atëherë duhet të zgjidhet opioni 1- **SIPAS NUMRIT TE FATURES** (i cili vlen deri sa të kryhet mbyllja ditore) dhe në ekran na shfaqet figura si mëposhtë:



Pastaj kalohet kartela më të cilen është kryer shitja dhe ipet PIN-i.

Pasi të jetë kaluar kartela, ipet PIN -i dhe është ekzekutohet anulimi me butonin ENTER, në ekran paraqiten të dhënat si në vazhdim.

Këto të dhëna vlejné për të gjitha rastet kur ekzekutimi bëhet në Terminal, këto të dhëna paraqesin lidhjen (komunikimin) e Terminalit me Qendrën Procesuese:


- **GPRS duke u lidhur...**
- **Duke marrur/ duke perpunuar...**
- **Aprovuar xxxx...**

RIPRINTIMI FATURËS


Zgjidh opcionin në ekran RIPRINTO, me ndihmën e tastit **F3**, si në figurën e mëposhtme:



Pasi të kemi zgjidhur opcionin RIPRINTO, në ekran na shfaqen menut si në figurën e mëposhtme:



Nëse dëshirojmë të riprintojmë faturën e fundit, atëherë zgjidhim opcionin – E FUNDIT, mirëpo nëse dëshirojmë të riprintojmë ndonjë faturë të mëhershme, duhet të zgjidhet opcioni 1- SIPAS NUMRIT TE FATURES dhe në ekran na shfaqet figura si mëposhtë:



The screenshot shows a terminal window with a dark background and white text. At the top, it says "VENDOS SHUMEN". Below that, it says "NR I FATURES". There is a white rectangular input field for the invoice number. At the bottom, there are two buttons: one with an "X" and one with a checkmark "✓".

MBYLLJE DITE

Zgjidh opcionin në ekran MBYLLJE D. me ndihmën e tastit **F4**, si në figurën e mëposhtme:




Pasi te keni zgjidhur këtë opsion Terminali vazhdon të komunikoj me Qendrën Procesuese deri në dhënjën e përgjigjes finale!

- **GPRS duke u lidhur...**
- **Duke marrur/ duke perpunuar...**
- **Aprovuar xxxx...**

Vërejtje: Pasi që është bërë mbyllja e ditës në POS,, për atë ditë nuk mund të bëhet anulim dhe riprintim.

FATURAT E TRANSAKSIONIT TE REALIZUAR DHE MBYLLJES DITORE



RISTARTIMI I POS TERMINALIT

Nëse keni problem me funksionimin e POS Terminalit, veprimi i parë që duhet të ndërmeret është ristartimi i POS Terminalit.

Ristartimi i POS-it bëhet duke shtypur butonin (.) dhe butonin Clear në të njëjten kohë sic është paraqitur në figuren e mëposhtme:



Në rast se edhe pas ristartimit të POS Terminalit nuk funksionon përseri, atëhere duhet të njoftohet Call Center e bankës **NLB**, në numrin kontaktues : **038/ 240 230 100**.

VENDOSJA / ZËVENDËSIMI I LETRËS NË TERMINAL

Në figurat në vazhdim, përmes shigjetave, është paraqitur procesi i vendosjes / zëvendësimit të letrës në POS terminal.

